

SHQIPËRIA MERR PËR HERË TË PARË PRESIDENCËN E KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB

Shqipëria ka marrë sot për herë të parë në historinë e saj Presidencën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Presidenca Shqiptare nisi me një Debat të Hapur të nivelit të lartë mbi “Forcimin e Llogaridhënies dhe Drejtësisë për Shkeljet e Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare” nën pikën e rendit të ditës Ruajtja e Paqes dhe Sigurisë, i cili u drejtua nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

“GRATË, PAQJA DHE SIGURIA”, SHQIPËRIA BËN BASHKË NË KËSHILLIN E SIGURIMIT BE - OSBE - OKB

MEPJ Olta Xhaçka kryesoi debatin e nivelit të lartë të Këshillit të Sigurimit mbi agjendën “Gratë, Paqja dhe Siguria”, ku theksoi se ngjarjet e fundit nëpër botë kanë ndikuar në mënyrë drastike në perspektivat për organizatat e grave, duke çuar edhe në ndërprerjen e angazhimeve konkrete për këtë agjendë. Agjenda për “Gratë, Paqen dhe Sigurinë” është një nga prioritetet kryesore të Shqipërisë në KS.

MINISTRJA XHAÇKA KRYESON TAKIMIN E KS PËR BASHKËPUNIMIN OKB-BE

MEPJ Olta Xhaçka kryeson takimin e radhës të KS me temë “Bashkëpunimi ndërmjet OKB-së dhe organizatave rajonale dhe nënrajonale (BE)”. Ministrja Xhaçka vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë mes OKB-së dhe BE, duke e cilësuar atë si thelbësor në adresimin e rritjes dhe kompleksitetit të krizave me të cilat përballet paqja dhe siguria ndërkombëtare.

SAMITI I NATO-S NË MADRID, MEPJ XHAÇKA TAKON WOPKE HOEKSTRA DHE PEKKA HAAVISTO

Ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka, ishte pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga kryeministri Edi Rama, që mori pjesë në Samitin e NATO-s në Madrid. Gjatë zhvillimit të samitit, Ministrja Xhaçka zhvilloi takime dypalëshe me Ministrin e Punëve të Jashtme të Holandës, Wopke Hoekstra dhe Ministrin e Punëve të Jashtme të Finlandës, Pekka Haavisto.

MINISTERIALI I SEECP/ MINISTRJA XHAÇKA: SHQIPËRIA E ANGAZHUAR NË ADRESIMIN E KËRCËNIMEVE QË RREZIKOJNË RAJONIN

MEPJ Olta Xhaçka mori pjesë në ministerialin e SEECP që u mbajt në Selanik, Greqi. Ajo vlerësoi angazhimin e kryesisë greke të SEECP-së për përbushjen me sukses të objektivave, teksa theksoi rëndësinë e procesit të zgjerimit dhe integritit evropian të vendeve të BP. Ministrja shprehu vullnetin e Shqipërisë për të marrë presidencën e nismës rajonale SEECP për periudhën 2024 – 2025.

MINISTRJA XHAÇKA TAKON TANJA FAJON: NJË MIKE DHE MBËSHTETËSE E FORTË E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BE

Ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka, ka zhvilluar një takim me Zv.Kryeministren dhe Ministren e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, Tanja Fajon. Ministrja Xhaçka uroi Tanja Fajon për marrjen e postit të Ministrit të Punëve të Jashtme, teksa vlerësoi mbështetjen që ajo ka treguar ndaj integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

MINISTRJA XHAÇKA TAKON SIR STUART PEACH: AVANCIMI I DIALOGUT KOSOVË-SERBI, KYÇ PËR STABILITETIN E RAJONIT

MEPJ Olta Xhaçka ka zhvilluar një takim me të Dërguarin Special të Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Sir Stuart Peach. Në fokus të takimit ishte situata në rajon dhe bashkëpunimi në kuadër të Këshillit të Sigurimit. Ministrja Xhaçka dhe Sir Peach shprehën dakordësinë se lufta në Ukrainë kërkon avancimin e dialogut Kosovë-Serbi dhe përmirësimin e situatës në Bosnje-Hercegovinë.

MINISTRJA XHAÇKANË DIALOGUN MINISTROR TË VENDEVE TË MESDHEUT MBI KRIZËN E PASIGURISË USHQIMORE

MEPJ Olta Xhaçka mori pjesë në takimin virtual “Dialogu Ministror i vendeve të Mesdheut mbi Krizën e Pasigurisë Ushqimore”, ku përgëzoi Italinë për iniciativën e ndërmarrë dhe bëri thirrje për të bashkuar forcat në gjetjen e një zgjidhjeje për këtë krizë të rëndë, e cila mund të përkeqësohet me kalimin e kohës.

SHËRBBIME KONSULLORE PËR SHQIPTARËT NË IRLANDË DHE KANADA

Gjatë muajit qershor filloi ofrimi i shërbimeve për dokumente biometrike, pasaporta dhe letërnjoftime elektronike për shqiptarët që jetojnë në Irlandë dhe Kanada.

